



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 16 shtator 2019

Z. Izedin Bytyçi, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 260/2019

Arta Berisha

kundër

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

I nderuari z. Bytyçi,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP)¹, më 20 mars 2019, ka pranuar ankesë nga znj. Arta Berisha, gazetare e angazhuar në projektin “E vërteta Online”, i cili realizohet në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve dhe Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), parashtruar kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja, më 22 shtator dhe më 11 tetor 2018, nëpërmjet postës elektronike, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht për qasje në të dhënat si në vijim: *A ka Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale buxhet për marketing në medie online dhe media sociale, cilat janë mediet dhe rrjetet sociale ku shpenzohet buxheti dhe për çfarë periudhe janë lidhur kontratat.* Këto të dhëna i ka kërkuar për vitin 2017 dhe 2018.

Avokati i Popullit, më 24 prill 2019, i është drejtuar me shkresë Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata lidhur me veprimet që MPMS-ja i ka ndërmarrë, përkitazi me kërkesën e ankueses për qasje në dokumentet e kërkuara. Meqenëse MPMS-ja nuk ka dërguar përgjigje në shkresën e datës 24 prill 2019, Avokati i Popullit, më 21 qershor 2019, i është drejtuar përsëri me shkresë Sekretarit të Përgjithshëm, por nuk ka marrë përgjigje.

Avokati i Popullit jua rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton të drejtën për qasje në dokumente publike: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.”* Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim*

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesja është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Prandaj në rastin konkret vlejnë rregullat e ligjit të vjetër.

të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetes, pa marrë parasysh kufijtë.”* Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”*

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi nga MPMS-ja i kërkesës së ankueses, përveçse është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, i përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”* Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq më vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit jua rikujton se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-ja ka vlerësuar: *“Liria e shprehjes përbën një nga themelet esenciale të një shoqërie demokratike, bazuar në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj, dhe është e zbatueshme jo vetëm për “informacion” apo “ide” të cilat pranohen apo vlerësohen. [...] Jo vetëm që shtypi ka për detyrë të transmetojë informacione dhe ide të tilla, por publiku gjithashtu ka të drejtë t'i pranojë ato. Sikur të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të “mbikëqyrësit publik”.²* Po ashtu, në rastin *Lingens v. Austria*, GjEDNj-ja jua rikujton: *“[...] të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Këto parime kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket shtypit.” [...] ³*

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara në nenin 12 të LQDP-së⁴. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

² Case of *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, (Application no. 13585/88, 26 November 1991, Paragraph 59 (a) (b)).

³ Case of *Lingens V. Austria* (Application no. 9815/82), 8 July 1986, paragraph 41.).

⁴ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesja është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Prandaj në rastin konkret vlejnë rregullat e ligjit të vjetër.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankueses, MPMS-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesja, gjë që është e sanksionuar me akte vendore si dhe instrumente ndërkombëtare.

Obligimi ligjor për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton se MPMS-ja, përveçse ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41 dhe neni 132, paragrafi 3), po ashtu ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga LQDP-ja dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të të drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i

REKOMANDON

Ministritë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

- ***Ta trajtojë kërkesën e ankueses dhe t'i përgjigjet asaj, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.***
- ***T'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit